



Kryetarit të Komunës së Suharekës Blerim Kuqi, i është caktuar një muaj paraburgim, si pasojë e mospërgjigjës së thirrjeve të Gjykatës për të dëshmuar në rastin e fundit të arrestimit të ish luftëtarëve të UÇK-së nga EULEX dhe

ku është i përfshirë edhe Fatmir Limaj.

Vendimi për dënimin e Kuqit është marrë vetëm pak minuta më parë, ndërsa agjencia e lajmeve ekonomisti ka mësuar se mbrojtësit e Kuqit do të bëjnë ankesë kundër vendimit të Gjykatës.

Dënimi me gjobë ose me paraburgim për dëshmitarët që nuk bashkëpunojnë është një masë e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.